

UDHËZIM
Nr. 32, datë 25.8.2020

“PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Në nenin 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH-së për disa furnizime”, paragrafi “ II.TRANSPORT”, germa “a) Transport udhëtarësh”, togfjalëshi “deri më 43 %”, bëhet “deri më 100 %”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj